



Koha për zgjedhjen e shkollës!

Për të zgjedhur shkollën para vitit shkollor 2025/2026

Vitin që fëmija juaj i mbush gjashtë (6) vite ai/ ajo është e mirëseardhur që të filloj parashkolloren në vjeshtë. Të gjithë kujdestaret duhet të bëjnë një përzgjedhje aktive të shkollës. Që nga viti 2018 parashkollorja është e obliguar, që do të thotë që nxënësi e ka shkollim të obliguar parashkolloren.

Zgjedhja është e hapur prej të hënës me 13 januar deri të hënën me 27 januar. Nuk mund të përzgjedhni një shkollë ose të vendoseni në radhë në një shkollë komunale para së mundësia për zgjedhjen e shkollës të jetë e hapur.

Ju do të zgjidheni së paku një shkollë, por ka mundësi që të zgjedheni më shumë shkolla.

Ju mund të bëni kërkesën njëkohësisht ,në shkollën komunale si dhe në shkollën e pavarur (private), në komunën e Trelleborgut. Në rast se Ju përcaktoheni në një shkollë të pavarur (private) Ju duhet që të dërgoni kërkesën paraprakisht në shkollën përkatëse. Pastaj (më vonë) e përzgjedhni shkollën në zgjedhjen e shkollës.

Ju e leni zgjedhjen e shkollës përmes faqës sonë:

<https://www.mittskolval.se/> . Në rast se fëmija i ka dy kujdestar, atëherë duhet të dy të bëjnë zgjedhjen. Është më rëndësi që të dy kujdestarët mos ta bëjnë zgjedhjen njëkohësisht. Njeri kujdestar te futet i pari dhe të bëjë zgjedhjen. Pastaj të futet kujdestari i dytë dhe ta miratojë atë zgjedhje.

Nëse nuk e bëni një zgjedhje, ose zgjedhja nuk është e vlefshme, atëherë enti i arsimit do të ju ofrojë një vend në një shkollë afër shtëpisë ku ju banoni. Kjo nuk duhet të jetë patjetër shkolla më e afërt e nxënësit. Në komunën e Trelleborgut, një shkollë llogaritet afër shtëpisë , në rast se gjendet në një rreze 3 km. Në rast se nuk gjendet një shkollë komunale në një rreze prej 3 km, atëherë llogaritet shkolla më e afërt nga adresa e nxënësit.

Në radhë të parë nxënësi vendoset sipas përzgjedhjes së kujdestarëve , mirëpo komuna mund të pyet dëshirat e kujdestarëve, për shëmbull së një shkollë nuk ka vende të lira për të gjithë që kanë zgjedhur. Në keto raste bëhet zgjedhja sipas kësaj renditje:

1. Nxënësit me identitet të mbrojtur.
2. Nxënësit që kanë vetëm një shkollë afër shtëpisë.
3. Nxënësit që kanë bërë zgjedhje aktive me motra dhe vëllëzër dhe kanë disa shkolla afër shtëpisë.

Përzgjedhje: 1) relativisht afër, 2) short

4. Nxënësit që kanë bër zgjedhje aktive pa motra dhe vëllëzer dhe kanë disa shkolla në afërsi të shtëpisë.
Përzgjedhje: 1) relativisht afërt, 2) short
5. Nxënësit që nuk kanë bër zgjedhje aktive në ndonjë shkollë, ose në disa shkolla që gjenden afër shtëpisë.
Përzgjedhje: 1) relativisht afër, 2) short

Më shumë informata për përzgjedhjen mund të i lexoni në udhëzimet për përzgjedhjen në parashkollore dhe në shkollën fillore në komunën e Trelleborgut. Faqja zyrtare: www.trelleborg.se/skolval

E rëndësishme të refuzohet zgjedhja e shkollës, në rast së nuk dëshironi një vend në shkollën në komunën e Trelleborgut

Në rast së ju dëshironi të merrni pjesë në zgjedhjen e shkollës, pasi që ju ka nda një vend jashtë komunës së Trelleborgut (komunale ose e pavarur) është me rëndësi të futeni në shërbimet elektronike dhe të refuzoni zgjedhjen e shkollës që ju ka nda më parë nga komuna e Trelleborgut.

Zgjedhja e shkollës mund të ndikoj në të drejtën për transportin shkollor.

Zgjedhja e shkollës , ndërrimi i shkollës, shpërngulja(ndërrimi i adresës së regjistruar) brenda komunës, mund të ndikoj në mundësit që të përzgjedh transportin shkollor. Me shumë informata mund të gjëni lidhur me transportin shkollor në faqën elektronike të komunës së Trelleborgut www.trelleborg.se/skolskjuts

Ndihmë lidhur zgjedhjen e shkollës. Në rast së keni nevojë për ndihmë për të përzgjedhur shkollën, ju mund të drejtoheni shërbimit për klient në tel. 0410-73 30 00 ose shkruani administratës së arsimit. skolval@trelleborg.se.

Më rëndësi të mëndoni në:

- Në rast së fëmija ka më shumë së një kujdestar duhet të dy të hyjnë në faqen e internetit për shërbim. Një kujdestar e bën kërkesën dhe tjetri kujdestar e aprovon pastaj kërkesën.
- Refuzoni zgjedhjen në rast së ju ka nda një vend në një komunë tjetër.
- Zgjedhja e shkollës mund të ndikoj në transportin shkollor.

Me shumë informata për zgjedhjen e shkollës

<https://www.trelleborg.se/barn-utbildning/grundskola-och-forskoleklass/val-av-skola/>

Në rast së keni pyetje lidhur me përzgjedhjen e shkollës jeni të mirëpritur të na kontaktoni: skolval@trelleborg.se

Miqësisht:

Bildningsförvaltningen Trelleborgs kommun

Bildningsförvaltningen
Henry Dunkers gata 1, 231 45 Trelleborg
Telefon: 0410-73 30 00
www.trelleborg.se | trelleborgs.kommun@trelleborg.se

Fakturaadress:
Box 79, 231 21 Trelleborg
Org.nr: 212000-1199